



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 4639/Prot.
1

Tiranë, më 16.07.2021

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1453, datë 22.02.2010.

**SHOQËRISË “GJOMAKAJ GROUP” SH.P.K
Rr."Bogdani", Pall.32, shk.1, kt. 6, Apart.3, Tiranë**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “GJOMAKAJ GROUP” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të shfrytëzimit Nr.1453, datë 22.02.2010, për mineralin Krom, në objektin “Qafë Luzhë”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.2160, datë 02.06.2021, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.4639, Prot, datë 03.06.2021, është propozuar revokimi i Lejes së Shfrytëzimit Nr.1453, datë 22.02.2010, për mineralin Krom, në objektin “Qafë Luzhë”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, sepse në objekt ka ndërprerë aktivitetin minerar për një vit.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe ndryshimet e tij Nr.134/2014 datë 09.10.2014.


Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen minerare të shfrytëzimit Nr.1453, datë 22.02.2010**, për mineralin Krom, në objektin “Qafë Luzhë”, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës, që shoqëria juaj zotëron.

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes minerare të shfrytëzimit **Nr.1453**, datë **22.02.2010**, për mineralin **Krom**, në objektin **“Qafë Luzhë”**, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E BURIMEVE NATYRORE
DREJTORIA MINERARE

Nr. 2160 Prot.

Tiranë më ⁰⁶ 02/05/2021

Lënda: *DËRGOHET PROPOZIM PËR REVOKIM LEJE MINERARE.*
(Për lejen minerare të shfrytëzimit Nr.1453, Dt. 22.02.2010)

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Drejtoria e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë
dhe Energjisë

TIRANË

Në zbatim të ligjit Minerar Nr.10 304 datë.15.07.2010, me ndryshimet e tij, Nr. 134/2014 datë 09.10.2014. Neni "43", Pika "2", gërma "b" dhe pika "4", nga specialistë të Sektorit Operativ Metalor në Drejtorinë Minerare, në AKBN-ë, kreu mbikëqyrjen e aktivitetit minerar në Bashkinë Prrenjas, nga data 17.05.2021 – 21.05.2021. Nga mbikëqyrja që u bë në Dt.19.05.2021, për lejen minerare Nr.1453, Dt. 22.02.2010, subjektit "Gjomakaj Group", Shpk, që e ushtron këtë veprimtari në Tropojë, objekti i mineralit të kromit "Qafë Luzhë" tropojë, grupi i specialistëve arriti në konkluzionin se:

1. Në objekt nuk punohet për më shumë se një vit kalendarik.
 2. Subjekti nuk ka miratuar planin vjetor të punës në AKBN.
- *Bazuar në Nenin 47 "pika 1" Gërma "c" të ligjit Minerar, Nr.10 304 datë 15.07.2010, dhe me ndryshimet e tij, Nr. 134/2014 datë 09.10.2014.*
 - *Zotëruesi i lejes minerare pezullohet për një vit ose ndërpret veprimtarinë minerare, duhet të njoftojë jo më vonë se 90 ditë kalendarike, strukturat përgjegjëse të veprimtarisë minerare.*
- Për sa më sipër propozojmë që leja minerare e shfrytëzimit Nr.1453, Dt. 22.02.2010, që zotërohet nga subjekti "Gjomakaj Group" Sh.p.k, të Revokohet.

Faleminderit për mirëkuptimin

DREJTORI EKZEKUTIV



Adresa: Bulevardi "Bejran Curri", Blloku "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri.
Tel. +355 (0) 4 225 7117; Fax +355 (0) 4 225 7382